



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË

Rr. Xhorxh Bush, nr. 31, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-222970 • E-mail: filologjia@uni-pr.edu • www.filologjia.uni-pr.edu

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë

Nr. prot.: 01/3920

Datë: 06/07/2022

Mbështetur në nenin 76 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, dt. 12.10.2012, Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me nr. prot. 1/95, datë 24.6.2021 dhe në zbatim të Konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP-së me Nr.Prot. 01/217, datë 01/06/2022, Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 06.07.2022, mori

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazë Ankesa me nr. prot. 03/3719, datë 29/06/2022 e kandidatës Gentiana Paçarizi kundër Vendimit me nr. prot. 01/3633, datë 23/06/2022 për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve në programet e Fakultetit të Filologjisë.
- II. **VËRTETOHET** Vendimi me nr. 01/3633, datë 23/06/2022, për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve për programet e Fakultetit të Filologjisë sipas Konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të UP-së me Nr.Prot. 01/217, datë 01/06/2022.
- III. Mbeten në fuqi raportet e komisionit vlerësues për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ushtrimeve si në vijim:
 1. Raporti me Nr.Prot. 03/3554 (pozita III.1, për lëndët: Shkrim akademik, Komunikim organizativ, Diksioni, Maskultura),
 2. Raporti me Nr.Prot 03/3555 (pozita III.2 për lëndët: Histori e gazetarisë evropiane, Komunikim strategjik, Intervista & Talkshou),
 3. Raporti me Nr.Prot 03/3556 (pozita III.3 për lëndët: Media dhe politika, Sociologji e komunikimit, Infotainment, Edukimi medial.),
 4. Raporti me Nr.Prot 03/3557 (pozita III.4 për lëndët: Multikulturalizmi, Marketingu dhe Advertajzingu, Histori e gazetarisë shqiptare, Menaxhimi i medias),
 5. Raporti me Nr.Prot 03/3558 (pozita III.5 për lëndët Radiogazetaria, Gazetari televizive) d
 6. Raporti me Nr.Prot 03/3559 (pozita III.6 për lëndët: Editorial, Koment dhe Analizë, Bazat e komunikimit masiv I e II, Metodat e kërkimit në shkencat e komunikimi).

Arsyetim

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë, në mbledhjen e mbajtur më 06.07.2022, ka shqyrtuar dhe miratuar Raportin me nr. prot. 03/3882, datë 05.07.2022, të komisionit për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve të pakënaqur lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në programet e Fakultetit të Filologjisë, sipas Konkursit me nr. prot. 01/217, datë 01/06/2022 të Senatit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (shih Raportin e Komisionit të ankesave nr. 03/3882)

Duke marrë parasysh atë çfarë u tha rënë lart, u vendos si në dispozitiv.

Vendimi t'u dërgohet:

- Arkivit të fakultetit
- Komisioneve vlerësuese
- Prodekanit për mësimdhënie dhe çështje për studentë
- Departamenteve përkatëse
- Zyrës për TI (për publikim në uebfaqe)

UNIVERSITETI PRISHTINË
"HASAN PRISHTINA"
PRISHTINE
FAKULTETI I FILOLOGJISË
DEKANË
Prof. dr. Lindita Rugova



**Raporti i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në lidhje me Konkursin e datës
01.06.2022, me numër protokolli 01/217**

Komisioni për shqyrtimin e ankesave, i emëruar me vendim të Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, më 14.06.2022, me nr. prot. 01/3808, është mbledhur më 05.07.2022 për ta shqyrtuar ankesën e kandidatës Gentiana Paçarizi (nr. prot. 03/3719, dt. 29.06.2022). Komisioni për ankesa gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë ka marrë parasysh dosjen (kopjet fizike të dokumenteve) me të cilat kandidati ka aplikuar për angazhim në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime në pozitat nr. III.1, III.2, III.3, III.4, III.5, III.6, dhe raportet e Komisioneve vlerësuese për pozitat në fjalë.

Parashtruesja e ankesës pretendon se *“më është mohuar e drejta e zgjedhjes së vendit të punës”*, duke shtuar se *“Rregullorja në fjalë (...) ka boshllëk ligjor”*.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës komisioni ka konstatuar se ankesa e kandidatës në fjalë është e pabazë, sepse shqyrtimi i ankesave bëhet pikërisht në përputhje me kriteret e Rregullores së procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me nr. prot. 01/95, e datës 24.06.2021, respektivisht me paragrafin e 9 të nenit 7, i cili precizon se *“Në Universitet të Prishtinës nuk mund të angazhohen kandidatët, të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie pune të rregullt apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare.”*

Me sa u tha më lart, ankesa e Gentiana Paçarizit refuzohet.

Prishtinë, më 05.07.2022

Komisioni:

1. Prof. ass. dr. Isa Sulçevsi – kryetar

2. Prof. ass. dr. Shpëtim Elezi – anëtar

3. Prof. ass. dr. Faton Ismajli – anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I FILOLOGJISË
PRISHTINË

Pranuar me: 05/07/2022			
Nj. org.	Numer	Shtojca	Vlera
03	3808	3	✓